



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE

Bazuar në V.K.M-në Nr. 780 datë 26.12.2018, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” të ndryshuar studentët e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” dhe “Master Profesional” përfitojnë reduktim deri me 50 % të tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2020 – 2021, pasi plotësojnë kriteret e pikave të VKM-së si më poshtë:

1/a) Studentët me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, studentë që nuk shikojnë (Verbër)/tetraplegjikë/paraplegjikë/me aftësi të kufizuar,

1/a) Studentët fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të KMCA-së për punë, familjet e të cilëve trajtohen/përfitojnë nga ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

1/b) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore,

1/b) studentëve deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit, pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, me të ardhura vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve;

1/c) Studentët, që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç;

1/ç) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë;

1/d) Studentët deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktima të trafikut të qenieve njerëzore;

1/dh) Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brëndshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria/institucioni përgjegjës;

1/e) Studentët romë dhe Ballkano-egjiptianët, konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale.

1/ë) Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;

1/f) Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë teëstudimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë);

1/g) Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të rregjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.

“Studentët aplikojnë për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, me dokumentacionin provues të plotësimit të kriterëve (dokumentacioni i nevojshëm gjendet të linku në fund), jo më vonë së muaji Dhjetor 2020”.

Kujdes! Dokumentacioni (plotësimi i dosjes së aplikantit pasi të keni shkarkuar **FORMULARIN E APLIKIMIT** tek linku i mëposhtëm), duhet të dorëzohet pranë Zyrës së Financës së FIMIF nga ora 8:00-16:00. Për çdo paqartësi, informohuni nga punonjësit e Zyrës së Financës së fakultetit.